



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË - KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE "Dr. Fatmir Krasniqi" FUSHË KOSOVË

Bazuar në nenin 80, 81, dhe 82, të Ligjit për Zyrtarët Publik, nr. 08/L-197, 8. të Ligjit të Punës nr. 03/L-21, 2, Vendimit nr. 163, të dt. 06/02/2024, të Këshillit Drejtues dhe Aprovimit nga DSHMS të Propozimit nr. 164, të dt. 06/02/2024, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare: "Dr. Fatmir Krasniqi" Fushë Kosovë, shpall:

K O N K U R S

Për themelimin e mardhënies së punës me afat të pacaktuar

- I. Titulli i vendit të punës: Doktor i mjekësisë (Mjek/e i/e përgjithshëm/e)
- Institucioni: QKMF "Dr. Fatmir Krasniqi" Fushë Kosovë
- Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit publik
- Numri i Pozitave: 1 (një)
- Titulli i mbikqyrësit: Shefi i Njesisë, Kryeshefi i departamentit të MF-QKMF-së
- Grada/koeficienti: H 10 Koeficienti 7.4
- Kohëzgjatja e emërimit: Në kohë të pacaktuar,
- Vendi i punës: QMF Bardh i Madh,
- Afati i aplikimit, nga data: 09/02/2024, deri më: 08/03/2024.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas përshkrimit të detyrave të punës në Qarkoren Informativ Nr. 02/2017 (M.SH. dt. 24/07/2017).
- Ofron shërbime me standard të lartë bazuar në mjekësinë e bazuar në dëshmi,
- Ofron shërbime gjithëpërfshirëse për individin/pacientin,
- Harton dhe zhvillon planin e trajtimit të sëmundjeve,
- Përcakton diagnozë diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjinë,
- Ofron kujdes për rastet urgjente dhe i referon ato me kohë dhe në mënyrë adekuate,
- Referon pacientin për trajtim spitalor, etj.

Kushtet dhe kriteret:

- të jetë shtetas i/e Republikës së Kosovës (kopja e Letërnjoftimit),
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar,
- të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin mbi gjuhët,
- të jetë i/e aftë në pikëpamje shëndetësore (Certifikata e mjekut, pas pranimit në mardhënie pune),
- të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje (dëshmi me shkrim nga Organi kompetent),

- të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e Zyrtarit publik,
- të ketë të kryer Fakultetin e Mjekësisë-drejtimi i përgjithshëm (diploma ose Certifikata(fotokopje)
- personat që kan diplomuar jashtë R.së Kosovës,duhet të kenë të nostrifikuara diplomat në MASHT,
- të jetë i/e regjistruar dhe licencuar në M.SH.-Oda e Mjekëve (Licenca e punës),
- të ketë aktivitete dhe trajnime të realizuara dhe të dëshmuara,
- të ketë shkathtësi pune i/e pavarur dhe në ekip,
- të ketë njohuri të punës me Kompjuterë dhe
- të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet,pa dallim moshe,gjinie,etnie,religjioni ose race.

INFORMATË E PËRGJITHËSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Mënyra dhe afati i aplikimit

Pranimi në detyrë,bazohet në parimet e mundësive të barabarta,meritës dhe integritetit,mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve.Procesi përzgjedhës do të bazohet gjithashtu në një proces profesional,transparent e të drejtë,bazuar në vlerësimin e njohurive ,aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve,ku përfshihet një testim me shkrim dhe me gojë.

Data e njoftimit në webfaqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net>,është nga data:09/02/2024.

Përveç webfaqes unike të procedurave të konkurimit,konkursi publikohet edhe në web-faqen zyrtare të Komunës.

Aplikacionet merren në katin e II-të -Arkiva e QKMF-ës,ose mund të shkarkohet nga web-faqja zyrtare e Komunës së Fushë Kosovës,dhe të plotësuara dorëzohen personalisht në Arkivë të QKMF-së,ng ora 07,00,-15,00 h ose dërgohen me postë në adresën: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare"Dr.Fatmir Krasniqi" Fushë Kosovë,Rruga "Bedri Pejani"p.n.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakumpletuara nuk do të pranohen.

Drejtor,

Dr.Remzi Shala

